



Prishtinë, 13 prill 2018

Komunikatë për media

Mbledhja e dytë (II) e Bordit të ZRRE për vitin 2018

Me 13 prill 2018, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka mbajtur mbledhjen e tij të dytë me radhë për këtë vit, ku janë shqyrtuar një varg çështjesh që kanë të bëjnë me rregullimin e sektorit të energjisë në vend.

Bordi fillimisht ka shqyrtuar dhe ka aprovuar bilancet vjetor të energjisë termike të ndërmarrjeve për ngrohje qendrore të qytetit të Prishtinës "NQ Termokos" dhe atë të qytetit të Gjakovës "NQ Gjakova".

Gjithashtu Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar kërkesat për licencim për kryerjen e aktiviteteve të furnizimit me energji elektrike të ndërmarrjeve "SharrCem" SH.P.K.; "JAHA COMPANY" SH.P.K.; dhe "FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS" SH.P.K.. Licencimi i këtyre tri kompanive ka ngritur numrin e të licencuarve që kryejnë këtë aktivitet në gjashtë operatorë duke krijuar kështu kushte të favorshme për një konkurrencë të lirë në tregun e furnizimit me energji elektrike.

Në këtë mbledhje Bordi i ka vazhduar licencën për furnizimit me shumicë (tregti) të energjisë elektrike ndërmarrjes "Danske Commodities Kosovo" SH.P.K. si dhe ka aprovuar kërkesat e pesë kompanive, për vazhdim të afateve të vlefshmërisë së Autorizimeve Preliminare, të lëshuara për ndërtim të kapaciteteve të reja të energjisë nga Burimet e Ripërtërishme.



Takimi i dytë i Bordit të ZRRE - 13 prill 2018

Ndër çështjet të tjera Bordi ka aprovuar edhe Planin për Menaxhimin e Rrezeqeve, një dokument ky që u vlerësua si mjaft i rëndësishëm për planifikim të duhur dhe organizim në parandalimin e rrezeqeve të cilat mund të shfaqen dhe të ndikojnë në funksionimin e ZRRE. Në këtë mbledhje po ashtu është vendosur që të hapet procedura e tenderimit për zgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) do të zgjidhet furnizuesi i cili ofron Koston më të ulët Direkte me Pakicë të Furnizimit me energji elektrike, siç është definuar në Rregullën për furnizuesin e mundësisë së fundit. Sipas kësaj Rregulle FMF do të sigurojë të gjitha shërbimet e furnizimit ashtu siç janë të përcaktuara në Ligjin për Energjinë Elektrike, Rregullën për



Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe në licencën përkatëse të lëshuar nga Rregullatori. Furnizuesi i mundësisë së fundit do të caktohet për një periudhë veprimi prej tre (3) vitesh dhe do të obligohet të furnizoj konsumatorët që ngelin pa furnizues në rastet kur furnizuesi i tyre ka bankrotuar apo është në procedurë të likuidimit, kur licenca e furnizuesit të mëparshëm është revokuar përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, dhe në rastet kur konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e furnizuesit të ri pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm.

Në mungesë të kohës së mjaftueshme për shqyrtim dhe të rëndësisë strategjike që kanë për zhvillimin e sektorit, Bordi ka vendosur që të shtyjë aprovimin e Parametrave Rregullative të Periudhës së Dytë Rregulluese dhe atë të Bilancit vjetor të Energjisë Elektrike.